

URDHËR
Nr.4, datë 12.1.2011

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE TAKSIMETRAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Njësitë e qeverisjes vendore, që sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe vendimit nr.1065, datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël, të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetra” të Këshillit të Ministrave, kanë bërë rimbursimin e subjekteve të biznesit të vogël, brenda datës 30 prill 2011, paraqesin pranë Ministrisë së Financave (sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri) kërkesën për vlerën që kërkohet për t’u rimbursuar deri në atë periudhë.

2. Kërkesa e njërive të qeverisjes vendore duhet të përmbajë:

a) Kërkesën me shkrim të firmosur nga nëpunësi i autorizuar i njësisë, me vlerën e fondit që kërkohet për t’u rimbursuar deri në atë periudhë.

b) Listën e subjekteve të biznesit të vogël që kanë përfituar rimbursim për pajisjen fiskale dhe taksimetra (vlerën e saj, përfshirë edhe TVSH-në, por jo më shumë se vlera e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1065, datë 29.12.2010) për ato subjekte që nuk janë të përfshirë në skemën e TVSH-së dhe që nuk regjistrohen në këtë skemë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.10 354, datë 18.11.2010, të rakorduar me degën rajonale të tatim-taksave.

3. Rakordimi i njësive të qeverisjes vendore me degët rajonale të tatim-taksave të bëhet në përputhje me kërkesat e pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1065, datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetra”.

4. Kërkesat për rimbursim dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave, e cila i administron këto kërkesa deri në përfundimin e procedurës për rimbursimin e njësive vendore, që kanë bërë kërkesë. Dokumentet origjinale do të arkivohen në protokollin e Ministrisë së Financave.

5. Me marrjen në dorëzim të këtij dokumentacioni, Ministria e Financave propozon projektvendimin pranë Këshillit të Ministrave, për rimbursimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël për njësitë e qeverisjes vendore, sipas vlerave përkatëse, nga zëri kontigjencë, parashikuar në buxhetin e vitit 2011. Ky fond, te njësitë e qeverisjes vendore do të kompensojë pjesën e taksës së biznesit të vogël, e cila ka rimbursuar pajisjen fiskale apo taksimetra.

6. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të vendimit për kompensim të njësive të qeverisjes vendore, Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), bëjnë alokimin e fondeve për rimbursim sipas njësive të qeverisjes vendore, te degët përkatëse të thesarit.

7. Transferimi i fondeve do të kryhet te degët e thesarit: Ministria 10, kapitulli 01, programi 01120, artikulli 6870000 (Shpenzime të jashtëzakonshme), me kodet përkatëse të degës së thesarit. Shkresa do të shoqërohet me listën e njësive dhe fondeve përfituese.

8. Me marrjen e njoftimit, njësitë e qeverisjes vendore përpilojnë një faturë për arkëtim për vlerën e taksës së biznesit të vogël, të cilën duhet ta paraqesin në degën e thesarit.

Me marrjen e shkresës nga Ministria e Financave dhe faturës për arkëtim nga njësia e qeverisjes vendore, dega e thesarit do të bëjë xhirim të brendshëm, për çdo njësi, sipas vlerës në listën bashkëlidhur shkresës së Ministrisë së Financave, në artikullin/llogarinë 7002100 (taksa e biznesit të vogël), të çdo njësie të qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCVE
Ridvan Bode

Bashkia/komuna _____

Datë.....2011

Nr. rendor	Emërtimi i subjektit	Vlera e plotë e pajisjes fiskale	Vlera e rimbursuar	Vlera e plotë e taksimetrit	Vlera e rimbursuar	Shuma që kërkohet për t'u kompensuar (lekë)
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
	Totali					

Drejtori/përgjegjësi i tatim-taksave

Kryetari i NJQV-së

Dega rajonale e tatim-taksave

Logoja e njësisë e qeverisjes vendore

Nr.....prot

Data.....2011

Për: Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit
Ministria e Financave, Tiranë

Lënda: Kërkesë për rimbursim të vlerës së taksës së biznesit të vogël

Në bazë të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011" dhe urdhrit nr...., datë2011, të Ministrit të Financave, bashkia/komuna kërkon rimbursimin e vlerës prejlekësh, të taksës së biznesit të vogël, me anë të së cilës ajo ka kompensuar bizneset për pajisjet fiskale dhe taksimetrat, deri në datën2011.

Bashkëlidhur, lista e detajuar e subjekteve dhe vlera e kërkuar, si dhe lista e rakorduar me degën rajonale të tatim-taksave.

Kryetari i NJQV

.....